



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0372

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AGIMI DE SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit me numër të prokurimit 623-26-2019-1-2-1, me 26/06/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE AGIMI DE SH.P.K. me nr. 2026/0372, e datës 10/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit me numër të prokurimit 623-26-2019-1-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit me numër të prokurimit 623-26-2019-1-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik AGIMI DE SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.04.2026. KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunes se Rahovecit” me nr. të prokurimit: "623-26-2019-1-2-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 35,000.00 €.

Me 22.05.2026. KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË. duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE “Mebli Dizajn SH.P.K.

Me 29.05.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 01.06.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.06.2026, OE AGIMI DE SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2026/0372 kundër vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AGIMI DE SH.P.K” janë parashtruar si në vijim:

Komisioni vlerësues, gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë, nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht me dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik.

AK/Zyra e Prokurimit, më 22.05., ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë OE të renditur të dytin, "Mebli Dizajn" SH.P.K.

Kompania jonë është eliminuar me arsyetimin, citoj:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju, si Operator Ekonomik, nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së Tenderit, Seksioni II – Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Mungesa e identifikimit të kodit të mostrave në formularin e tenderit elektronik. Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit, ku kërkohet që Operatori Ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar, duke e lënë atë të paplotësuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

Neni 32, pika 32.5: Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet ti specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.

Juve, si Operator Ekonomik, nuk e keni identifikuar kodin e mostrave në formularin elektronik. Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit, ku kërkohet që operatori ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

Ky konstatim i AK/Komisionit Vlerësues nuk qëndron. Në formularin e tenderit, te pjesët e tenderit që dorëzohen ndaras, ne kemi cekur "Mostrat".

AK, në letrën standarde për eliminim, ka cituar nenin 32.5 të Rregullores për Prokurim Publik. Ne kemi dorëzuar ofertën dhe mostrat në përputhje me këtë dispozitë ligjore, citoj:

32.5 Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet ti specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.

Në nenin 32.5 të Rregullores për Prokurim Publik nuk specifikohet se duhet të përshkruhet kodi i mostrave në formularin e tenderit. AK/Zyra e Prokurimit tenton ta interpretojë në një formë tjetër këtë dispozitë ligjore me qëllim të eliminimit të ofertës sonë.

Ne, në formularin e tenderit, kemi specifikuar pjesët e tenderit që dorëzohen ndaras: Mostrat.

Në bazë të nenit 37.4 të Rregullores për Prokurim Publik, në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, mostrave të dorëzuara duhet tu eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE.

Edhe AK/Zyra e Prokurimit, në hartimin e kriterit nr. 3 në FDT lidhur me mostrat, ka cekur se mostrat duhet të dorëzohen konform nenit 37 të Rregullores për Prokurim Publik, citoj:

Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik: Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet:

- a. tu eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe
- b. të shënohen me një kod.

Në procesverbalin për dorëzimin e mostrave, ne jemi identifikuar me kodin 2804 nga zyrtari i prokurimit, i cili ka pranuar mostrat, dhe nuk ka ndonjë parregullsi në dorëzimin e mostrave. Prandaj, arsyeja për eliminim nuk qëndron.

Autoriteteve Kontraktuese, në bazë të neneve 52.3, 56.3 dhe 59.4 të LPP-së, nuk u lejohet ta eliminojnë operatorin ekonomik në bazë të një kërkesë e cila më parë nuk është parashtruar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

AK, përveç që ka eliminuar kompaninë tonë pa të drejtë, në anën tjetër ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm, i cili nuk ka plotësuar kriterin nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, pasi nuk ka dorëzuar katalogun për të gjitha produktet.

Kriteri nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në FDT është parashtruar si më poshtë:

Kërkesa 2: Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë/broshura.

Dëshmia 2: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë/broshura për produktet e ofruara, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve, siç kërkohet në specifikimet teknike.

OE ka dorëzuar katalog vetëm për pozicionet nr. 14, 16, 18, 20, 22, 26, 34, 35, 36, 40, 49, 50, 51, 53, 62, 65, 68, 70, 71 dhe 73, ndërsa për produktet me numër rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 63, 64, 66, 67, 69 dhe 72 fare nuk ka dorëzuar katalogun dhe specifikimet teknike.

Në bazë të Rregullores dhe Udhëzimit për Prokurim Publik, në rast kur mungon specifikimi teknik dhe katalogu për produktet e ofertuara, kusht administrativ është që tenderi të refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

AK/Zyra e Prokurimit, në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, fare nuk e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor.

Prandaj, konstatojmë se OE "Mebli Dizajn" SH.P.K. është i papërgjegjshëm.

Marrë parasysh faktet e lartcekura, konstatojmë se AK/Komisioni Vlerësues në mënyrë të jashtëligjshme ka vendosur për eliminimin e ofertës sonë dhe shpërblimin me kontratë të OE-së së papërgjegjshme, e cila ka dorëzuar ofertë me çmim më të lartë.

Si pasojë e shkeljeve të lartcekura nga AK/Komisioni Vlerësues, ka ardhur deri te eliminimi i ofertës sonë pa të drejtë. Në këtë mënyrë, na është mohuar fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontratë dhe nuk është respektuar neni 60 i LPP-së, sipas të cilit kontrata duhet ti jepet kompanisë sonë si tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, pas shqyrtimit të provave dhe fakteve, ta aprovojë ankesën e kompanisë sonë si të bazuar dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik AGIMI DE SH.P.K., me adresë në Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunes së Rahovecit", me numër të prokurimit: 623-26-2019-1-2-1, numër i brendshëm: 623-26-005-1-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës 22.05.2026, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim më datë 29.05.2026, sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Nr. 04/L-042.

Baza ligjore për refuzimin e kërkesës

Ju sqarohet se pretendimet tuaja ankimore nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Rahovecit, ju ka njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas Formularit B42 – Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju, si Operator Ekonomik, nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së Tenderit, tek Seksioni II – Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Mungesa e identifikimit të kodit të mostrave në formularin e tenderit elektronik: Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit, ku kërkohet që Operatori Ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar, duke e lënë atë të paplotësuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

Neni 32, pika 32.5: Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet ti specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.

Juve, si Operator Ekonomik, nuk e keni identifikuar kodin e mostrave në formularin e tenderit elektronik. Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit, ku kërkohet që operatori ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik Ankimor

Përgjigje në pretendimin ankimor nga AK

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim me pretendimet se AK/Komisioni Vlerësues, gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë, nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht me dispozitat përkatëse, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar, për arsyet në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit është kërkuar:

Kërkesa 3: Operatorët ekonomik, bashkë me ofertën, duhet të dorëzojnë mostrat për pozicionet tek Përshkrimi i Çmimeve: 14, 16, 18, 20, 22, 26, 34, 35, 36, 40, 49, 50, 51, 53, 62, 65, 68, 70, 71 dhe 73, në pajtueshmëri me specifikat e materialit në këtë Dosje të Tenderit.

Mostrat do të dorëzohen në Zyrën e Prokurimit, 60 minuta para hapjes së ofertave. Me këtë rast do të vepohet konform nenit 37 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet:

- a. tu eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe
- b. të shënohen me një kod.

Në Regjistrin e Mostrave të dorëzuara nga Operatori Ekonomik e kemi këtë formular.

Në pretendimin tuaj, ndër të tjera, keni cekur:

32.5 Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet ti specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.

Sipas nenit të cekur më lart të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ceket se gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet ti specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.

Në formularin e dorëzimit të tenderit, të dorëzuar nga ana juaj, nuk e keni të vendosur/specifikuar kodin e mostrave për mostrat e pretenduara të dorëzuara nga ana juaj, ndërsa Rregullorja kërkon të specifikohen dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike në këtë formular.

Shih foton e formularit të dorëzuar nga ana juaj.

Shembull praktik sipas Rregullores: Nëse shikojmë formularin e dorëzimit të tenderit të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, gjejmë kodin e mostrave sipas Regjistrin të Mostrave të dorëzuara nga Operatori Ekonomik.

Në Regjistrin e Mostrave të dorëzuara nga Operatori Ekonomik dhe në Formularin e Dorëzimit të Tenderit kemi kodin: 2019/2026.

Sipas nenit 59, paragrafi 4 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues do ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Nga konstatimet e lartcekura u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.06.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0372 ndërsa me datë 19.06.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0372, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “AGIMI DE SH.P.K’eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0372 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar në tërësi dhe me kujdes të gjitha pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankues në ankesën e tij. Për qëllime të qartësisë, koherencës dhe për të shmangur përsëritjet e panevojshme, pretendimet ankimore në këtë raport paraqiten në formë të përmbledhur, duke ruajtur thelbin e secilit pretendim ashtu siç është ngritur nga ankuesi. Pas secilit pretendim të përmbledhur, jepet përgjigjja përkatëse e ekspertit.

Pretendimi ankimor nr. 1 (i përmbledhur)

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme e ka eliminuar ofertën e tij për shkak se nuk e ka identifikuar kodin e mostrave në formularin e tenderit elektronik. Sipas ankuesit, ai ka vepruar në përputhje me nenin 32.5 të Rregullores për Prokurimin Publik duke specifikuar në formularin e tenderit se pjesë e tenderit që dorëzohet ndaras janë mostrat, ndërsa as në Dosjen e Tenderit dhe as në nenin 32.5 të Rregullores nuk është kërkuar që në formularin e tenderit të evidentohet edhe kodi i mostrave. Ankuesi thekson se mostrat janë dorëzuar dhe pranuar nga Autoriteti Kontraktues, ndërsa kodi identifikues i tyre është evidentuar në procesverbalin e pranimit të mostrave.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit rezulton se në kërkesën nr. 3 Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që mostrat të dorëzohen para hapjes së ofertave, të mos përmbajnë elemente identifikuese të operatorit ekonomik dhe të shënohen me një kod. Megjithatë, në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është përcaktuar kërkesa që kodi identifikues i mostrave të evidentohet edhe në formularin e tenderit elektronik.

Po ashtu, neni 32.5 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton se operatorët ekonomikë duhet t'i specifikojnë në ofertën elektronike dokumentet që dërgohen në formë fizike, por nuk kërkon evidentimin e kodit identifikues të mostrave në formularin e tenderit.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se operatori ekonomik në formularin e tenderit ka deklaruar se pjesë e tenderit që dorëzohet ndaras është “MOSTRA”. Gjithashtu, nga Regjistri i Mostrave të Dorëzuara rezulton se mostrat janë pranuar nga Autoriteti Kontraktues dhe janë evidentuar me kodet identifikuese 2804, 2019/2026 dhe LR 89.

Eksperti shqyrtues vëren se Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar ndonjë mospërputhje lidhur me kodimin e mostrave të dorëzuara fizikisht, por eliminimin e ofertës e ka bazuar në faktin se kodi i mostrave nuk është evidentuar në formularin e tenderit elektronik.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës për shkak të mosshënimit të kodit të mostrave në formularin e tenderit elektronik nuk gjen mbështetje në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe as në dispozitat e nenit 32.5 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Prandaj, pretendimi ankimor nr. 1 vlerësohet si i bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 2(i permbledhur)

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik Mebli Dizajn SH.P.K., ndonëse i njëjti nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Sipas ankuesit, Dosja e Tenderit ka kërkuar dorëzimin e katalogëve/broshurave për produktet e ofruara, së bashku me përshkrimin e karakteristikave teknike, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar katalogë vetëm për një pjesë të produkteve. Ankuesi pretendon se për një numër të konsiderueshëm artikujsh (pozicionet 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 63, 64, 66, 67, 69, 72 dhe të tjerë) nuk janë dorëzuar katalogë që dëshmojnë përmbushjen e specifikimeve teknike. Sipas ankuesit, mungesa e këtyre katalogëve është dashur të rezultojë me shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme, ndërsa Autoriteti Kontraktues jo vetëm që nuk e ka eliminuar operatorin ekonomik të rekomanduar, por as nuk e ka trajtuar këtë pretendim në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr.2

Lidhur me kete pretendim ankimor , eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar dhe pretendimeve të paraqitura në ankesë, vlerëson se ky pretendim është i bazuar.

Nga kërkesa nr. 2 e Fletës së të Dhënave të Tenderit rezulton se operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar të paraqesin katalogë/broshura për produktet e ofruara, së bashku me përshkrimin e karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike. Po ashtu, në Aneksin 1 është përcaktuar se specifikat teknike janë të bashkangjitura/përshkruara në dokumentin “Përshkrimi i Çmimeve”.

Eksperti shqyrtues ka verifikuar katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar në raport me artikujt e përfshirë në dokumentin “Përshkrimi i Çmimeve” dhe ka konstatuar se katalogu i dorëzuar përmban vetëm një pjesë të produkteve të ofertuara, përkatësisht produktet që korrespondojnë me pozicionet 14, 16, 18, 20, 22, 26, 34, 35, 36, 40, 49, 50, 51, 53, 62, 65, 68, 70, 72 dhe 73, ndërsa për pozicionet 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 63,

64, 66, 67 dhe 69 nuk janë identifikuar katalogë apo broshura përkatëse.

Duke qenë se operatori ekonomik i rekomanduar ka ofertuar për të gjithë artikujt e përfshirë në aktivitetin e prokurimit, ndërsa kërkesa nr. 2 e FDT-së kërkonte paraqitjen e katalogëve/broshurave për produktet e ofruara, eksperti shqyrtues vlerëson se operatori ekonomik i rekomanduar nuk e ka përmbushur në tërësi këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit. Andaj pretendimi ankimor nr. 2 vlerësohet si i bazuar

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Dhe duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues të cilave ju fal besimin pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunes së Rahovecit” me nr. të prokurimit: "623-26-2019-1-2-1"

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtesat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues të cilit ja fal besimin e plotë dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje, ankesa e OE ankues kualifikohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e

prezantuarë si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - AGIMI DE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: